



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06

Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 23 Nëntor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave:
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit:
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit:
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 nëntor 2020, pas konfirmimit të aktakuzës ("Vendimi i Konfirmimit" dhe "Aktakuza e Konfirmuar"),² Kadri Veseli ("z. Veseli" ose "i akuzuari") u arrestua në bazë të vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.³
2. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesën e z. Veseli për lirim të përkohshëm ("Vendimi i Parë mbi Paraburgimin").⁴
3. Më 30 prill 2021, Gjykata e Apelit konfirmoi vendimin e parë për paraburgimin ("Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit").⁵

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetari, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, publik; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020, publike. Një version konfidencial me edhe më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 11 Dhjetor 2020, F00134. Në vijim të Vendimit në lidhje me Mangësitë në Formën e Aktakuzës (F00413/RED), më 8 shtator 2021 u dorëzuan një version i redaktuar konfidencial dhe një version i redaktuar publik i Aktakuzës së Konfirmuar të Korrigjuar, F00455/CONF/RED/A01 dhe F00455/RED/A01.

³ KSC-BC-2020-06, F00050, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit i Kadri Veselit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00027/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi*, 26 tetor 2020, publik ("Vendimi mbi Fletarrestimet"); F00027/A03/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Kadri Veselin*, 26 tetor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00178, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, publik.

⁵ KSC-BC-2020-06, IA001/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik.

4. Më 2 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli (“Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin”).⁶
5. Më 21 korrik 2021, pasi Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kishte kërkuar Mbrojtjes së z. Veseli (“Mbrojtja”) që të njoftonte nëse synonte të kërkonte shtyrjen e rishikimit të ardhshëm të paraburgimit, duke pasur parasysh apelin kundër Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin, apo nëse preferonte që paraburgimi i z. Veseli të rishikohej brenda dy muajve nga Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, Mbrojtja informoi se nuk kërkonte zgjatje afati dhe i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake të “vazhdonte me detyrimin [e tij] për rishikimin e paraburgimit sipas afateve ligjore”.⁷
6. Më 9 gusht 2021, Mbrojtja informoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake se e kishte rivlerësuar qëndrimin e shprehur më 21 korrik 2021 dhe i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake të pranonte parashtrime lidhur me rishikimin e paraburgimit të Z. Veseli brenda dhjetë ditësh nga vendimi i Gjykatës së Apelit mbi apelin e Mbrojtjes kundër Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin dhe më tej informoi se z. Veseli hiqte dorë nga e drejta për rishikimin e ndërmjetëm të paraburgimit (“Kërkesa e 9 Gushtit 2021”).⁸
7. Më 10 gusht 2021, në vijim të Kërkesës së 9 Gushtit 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndryshoi afatet për parashtrimet Mbrojtjes lidhur me atë nëse ekzistonin ende arsytet për vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli dhe e urdhëroi Mbrojtjen t’i dorëzonte ato jo më vonë se dhjetë ditë pas njoftimit të vendimit të Gjykatës së Apelit mbi apelin kundër Vendimit të dytë mbi Paraburgimin (“Vendimi i 10 Gushtit 2021”).⁹

⁶ KSC-BC-2020-06, F00380 F00380/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit të Kadri Veselit*, 2 korrik 2021, publik.

⁷ KSC-BC-2020-06, Transkripti, 21 korrik 2021, publik, f. 532, rreshtat 10-18, f. 533, rreshtat 13-15.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00429, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit lidhur me Rishikimin e Dytë të Paraburgimit*, 9 gusht 2021, publike, para. 2.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00430, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Veselit për Zgjatje të Afatit*, 10 gusht 2021, publik, para. 9, 11.

8. Më 1 tetor 2021, Gjykata e Apelit lëshoi vendimin mbi apelin e z. Veseli kundër Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin ("Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit")¹⁰; Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ia ktheu Vendimin e Dytë mbi Paraburgimin Gjykatësit të Procedurës Paraprake për shqyrtim të mëtejshëm, për të vlerësuar nëse Policia e Kosovës mund të zbatojë në mënyrë të efektshme kushtet e propozuara nga i akuzuari ose kushte të tjera të identifikuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake si të domosdoshme për zvogëlimin e rreziqeve të identifikuar.¹¹

9. Më 8 tetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Policinë e Kosovës të jepte informacion në lidhje me: (i) autoritetin dhe kapacitetin e Policisë së Kosovës për të kufizuar lëvizjet e individëve subjekt i lirit me kusht, për të monitoruar dhe kufizuar komunikimet e këtyre individëve, dhe për të administruar arrestin shtëpiak, si dhe zbatueshmërinë e kushteve që shoqërojnë lirin e përkohshëm; dhe (ii) raste të mëparshme të zbatimit të kushteve që shoqërojnë lirin e përkohshëm ose paraburgimin e personave të akuzuar për krime të rënda ("Urdhri për Policinë e Kosovës").¹²

10. Më 8 tetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Mbrojtjen të bënte me dije nëse dëshironte që: (a) paraburgimi i z. Veseli të rishikohej sipas kalendarit të përcaktuar në Vendimin e 10 Gushtit 2021; (b) paraburgimi i z. Veseli të rishikohej nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake së bashku me rishqyrtimin e Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin në një vendim përmbledhës, duke mbajtur parasysh udhëzimet e Gjykatës së Apelit dhe, në këtë rast, do të mbeteshin në fuqi afatet e përcaktuara në Vendimin e 10 Gushtit 2021; gjithashtu u bë me dije se, në qoftë se palët dëshironin të bënin komente mbi parashtrimet e Policisë së Kosovës,

¹⁰ KSC-BC-2020-06, IA008/F00004/RED, Gjykata e Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit*, 1 tetor 2021, publik.

¹¹ Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 51-53.

¹² KSC-BC-2020-06, F00513, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër drejtuar Policisë së Kosovës për Dorëzim Informacioni*, 8 tetor 2021, publik, me një shtojcë, konfidenciale.

Prokurori i Specializuar duhet t'i bënte parashtrimet brenda pesë ditësh nga njoftimi i përkthimit të tyre në gjuhën angleze dhe Mbrojtja brenda tri ditësh nga njoftimi i parashtrimeve të Prokurorit të Specializuar; ose që (c) rishikimi i ardhshëm i paraburgimit të shtyhej deri në dy muaj pas rishqyrtimit të Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ("Urdhri i 8 Tetorit 2021").¹³

11. Më 10 tetor 2021, Mbrojtja kërkoi që paraburgimi i z. Veseli të rishikohej në përputhje me afatet e përcaktuara në Vendimin e 10 Gushtit 2021 ("Parashtrimet e 10 Tetorit 2021").¹⁴

12. Më 11 tetor 2021, Mbrojtja dorëzoi parashtrimet lidhur me rishikimin e paraburgimit të z. Veseli,¹⁵ ku përfshiu informacionin e marrë pas kërkesës së Mbrojtjes drejtuar Policisë së Kosovës në lidhje me aftësinë e saj për të zbatuar kushtet për lirim të përkohshëm ("Parashtrimet e Para të Policisë së Kosovës"),¹⁶ dhe kërkoi që z. Veseli të lirohej sipas disa kushteve të caktuara ("Kërkesa").¹⁷

13. Më 13 tetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Administratoren të jepte informacion për kushtet e paraburgimit të zbatueshme për z. Veseli në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") (Urdhri për Administratoren").¹⁸

¹³ KSC-BC-2020-06, F00514, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër drejtuar Mbrojtjes për Paraqitjen e Parashtrimeve mbi Afatin për Rishikimin e Ardhshëm të Paraburgimit*, 8 tetor 2021, publik, para. 6.

¹⁴ KSC-BC-2020-06, F00515, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Parashtrime të Mbrojtjes së Veselit në pajtim me Urdhrin e 8 Tetorit 2021 (F00514)*, 10 tetor 2021, publik, para. 4.

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00518, Mbrojtës i Specializuar, *Parashtrime të Mbrojtjes së Veselit lidhur me Rishikimin e Dytë të Paraburgimit*, 11 tetor 2021, konfidencial, me shtojcat 1-2, konfidenciale. Një version i korrigjuar u dorëzua më 14 tetor 2021, F00518/COR, konfidencial, me shtojcat 1-3, konfidenciale.

¹⁶ KSC-BC-2020-06, F00518/COR/A01, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 1 e Versionit të Korrigjuar të Parashtrimeve të Mbrojtjes së Veselit lidhur me Rishikimin e Dytë të Paraburgimit (KSC-BC-2020-06/F00518, i datës 11 tetor 2021)*, 14 tetor 2021, konfidenciale; F00518/COR/A02, Mbrojtës i Specializuar, *Shtojca 2 e Versionit të Korrigjuar të Parashtrimeve të Mbrojtjes së Veselit lidhur me Rishikimin e Dytë të Paraburgimit (KSC-BC-2020-06/F00518, i datës 11 tetor 2021)*, 14 tetor 2021, konfidenciale.

¹⁷ Kërkesa, para. 22, 68.

¹⁸ KSC-BC-2020-06, F00522, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër drejtuar Administratores për Dorëzim të Informacionit mbi Regjimin e Paraburgimit*, 13 tetor 2021, konfidencial, para. 7.

14. Më 20 tetor 2021, Administratorja dorëzoi informacionin e kërkuar në Urdhrin për Administratoren ("Parashtrimet e Zyrës Administrative").¹⁹
15. Më 22 tetor 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS-ja") iu përgjigj kërkesës ("Përgjigjja").²⁰
16. Më 26 tetor 2021, Policia e Kosovës dorëzoi informacionin e kërkuar në Urdhrin për Policinë e Kosovës ("Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës").²¹
17. Më 29 tetor 2021, Mbrojtja informoi se do t'i përfshinte Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës në kundërpërgjigjen e saj të ardhshme ndaj Përgjigjes, kërkoi që ky aspekt të trajtohej menjëherë, dhe kërkoi leje për tejkalimin e numrit të fjalëve të kundërpërgjigjes së saj të ardhshme prej 1500 fjalësh.²²
18. Më 1 nëntor 2021, Mbrojtja iu kundërpërgjigj Përgjigjes ("Kundërpërgjigjja").²³
19. Më 8 nëntor 2021, ZPS-ja dorëzoi parashtrimet e saj lidhur me Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës ("Parashtrimet e ZPS-së").²⁴
20. Më 11 nëntor 2021 Mbrojtja iu përgjigj parashtrimeve të ZPS-së ("Parashtrimet e Mbrojtjes").²⁵

¹⁹ KSC-BC-2020-06, F00536, Administratorja, *Parashtrimet e Zyrës Administrative në pajtim me Urdhrin për Dorëzim të Informacionit mbi Regjimin e Paraburgimit*, (F00522), 20 tetor 2021, konfidencial.

²⁰ KSC-BC-2020-06, F00540, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes të Tetorit 2021 për Rishikimin e Paraburgimit*, 22 tetor 2021, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 2 nëntor 2021, F00540/RED.

²¹ KSC-BC-2020-06, F00548/eng, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, *Përgjigje në Kërkesë me numër KSC-BC-2020-06 datë 13 tetor 2021*, 26 tetor 2021, konfidenciale. Përkthimi në anglishte i këtij parashtrimi u protokollua më 3 nëntor 2021.

²² KSC-BC-2020-06, Transkripti, 29 tetor 2021, publik ("*Transkripti i 29 Tetorit 2021*"), f. 711, rreshti 18 – f. 712, rreshti 9; f. 749, rreshtat 19-21.

²³ KSC-BC-2020-06, F00556, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë lidhur me Parashtrimet e Mbrojtjes të Tetorit 2021 për Rishikimin e Paraburgimit*, 1 nëntor 2021, konfidenciale, me shtojcat 1-2, konfidenciale.

²⁴ KSC-BC-2020-06, F00562, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Policisë së Kosovës mbi Paraburgimin*, 8 nëntor 2021, konfidenciale, me shtojcën 1, publike.

²⁵ KSC-BC-2020-06, F00563, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë lidhur me Parashtrimet e Policisë së Kosovës mbi Paraburgimin me Shtojcën Publike 1*, 11 nëntor 2021, konfidenciale.

II. PARASHTRIMET

21. Mbrojtja parashtron se ka dy ndryshime në rrethana, që qartësisht shërbejnë si bazë për përfundimin e paraburgimit të z. Veseli në objektin e paraburgimit të DHS-së dhe që ai të mbahet në arrest shtëpiak, përkatësisht: (i) Parashtrimet e Para të Policisë së Kosovës përmbajnë garanci se Policia e Kosovës është më se e aftë dhe e gatshme për të zbatuar çdo kusht ose urdhër të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për lirimin e përkohshëm ose çdo aspekt tjetër; dhe (ii) koha që ka kaluar që nga Aktakuza e Konfirmuar dhe vonesat e ZPS-së në ndjekjen penale të kësaj çështjeje e bëjnë vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli në objektin e paraburgimit të DHS-së joproporcional, të rëndë dhe të paligjshëm.²⁶

22. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të rrëzohet.²⁷ Ajo argumenton se vazhdimi i paraburgimit të z. Veseli mbetet i nevojshëm duke qenë se nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm në rrethana që të zhvleftësojë arsyet e përcaktuara për paraburgim, dhe se Gjykata e Apelit ka konfirmuar se vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet e parashikuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.²⁸

23. Mbrojtja përgjigjet se duke pasur parasysh Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës, mbajtja e z. Veseli në objektin e paraburgimit të DHS-së duhet të përfundojë dhe ai duhet të vendoset në arrest shtëpiak në Kosovë.²⁹

24. Në Parashtrimet e saj ZPS-ja argumenton se Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës nuk sjellin asgjë që të çojë në ndryshimin e konstatimeve të mëparshme se lirimi me kusht nuk mund të zbatohet në mënyrë të efektshme, duke patur parasysh rreziqet që paraqet z. Veseli.³⁰

²⁶ Kërkesa, para. 22-25, 68.

²⁷ Përgjigjja, para. 42.

²⁸ Përgjigjja, para. 1.

²⁹ Kundërpërgjigjja, para. 4, 35.

³⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1.

25. Në Parashtrimet e Mbrojtjes, krahas kundërshtimeve për procedurën e ndjekur nga ZPS-ja në lidhje me Urdhrin e 8 Tetorit 2021 dhe për kuadrin e Parashtrimeve të ZPS-së³¹, Mbrojtja pretendon se Parashtrimet e ZPS-së nuk përbëjnë bazë për mbajtjen e z. Veseli në paraburgim.³²

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

26. Neni 41(6) i Ligjit parasheh që Dhomat e Specializuara urdhërojnë paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së dhe kur ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: i) përbën rrezik për arratisje; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë prova të veprës penale ose rrethana të caktuara tregojnë se personi do të pengojë ecurinë e procedurës penale; ose (iii) do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë ndonjë vepër penale në tentativë, ose do të kryejë ndonjë vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

27. Neni 41(10) i Ligjit dhe rregulla 57(2) e Rregullores parashikojnë se, deri në një vendim të formës së prerë apo lirim, pas kalimit të dy (2) muajve nga vendimi i fundit për paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim dhe nxjerr vendim për zgjatjen ose përfundimin e paraburgimit.

28. Neni 41(12) i Ligjit përcakton se përveç paraburgimit mund të urdhërohen edhe masat në vijim për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, apo për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve ose personave

³¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1

³² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 23, 41.

të caktuar, paraqitja në një stacion policie apo vend tjetër dhe masa alternative shmangëse.

29. Në përputhje me rregullën 56(2) të Rregullores, paneli siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes dhe, në rast të ndonjë vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, paneli, pas dëgjimit të palëve, mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

IV. DISKUTIM

A. ASPEKTE PARAPRAKE

1. Urdhri i 8 Tetorit 2021

30. Mbrojtja pretendon se sipas kalendarit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në opSIONIN A të Urdhrit të 8 Tetorit 2021, debatimi juridik i kësaj pike në lidhje me z. Veseli duhet të kishte përfunduar me kundërpërgjigjen e Mbrojtjes.³³ Ajo shton se, sa i takon z. Veseli, parashtrimet e ZPS-së përbëjnë kundërpërgjigje shtesë për të cilën gjykata nuk ka dhënë leje.³⁴ Sipas Mbrojtjes, ZPS-ja e ka shtyrë Mbrojtjen drejt opSIONIT B të Urdhrit të 8 Tetorit 2021, duke i krijuar në këtë mënyrë Mbrojtjes detyrimin për t'u kundërpërgjigjur.³⁵

31. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se Urdhri i 8 Tetorit 2021 bëri dallimin mes rishikimit të paraburgimit të z. Veseli sipas afatit të përdymuajshëm të parashikuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores nga njëra anë, dhe vendimit përmbledhës për rishikimin e rregullt dhe rishqyrtimin e Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit nga ana tjetër.³⁶ Për pasojë, opsioni i parë parashikonte dy vendime të veçanta,

³³ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 10.

³⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 11-13.

³⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 13-14.

³⁶ Urdhri i 8 Tetorit 2021, para. 6.

përkatësisht: (i) një vendim për rishikimin e përdymuajshëm të vendimit mbi paraburgimin e z. Veseli, pa marrë parasysh Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës; dhe (ii) një vendim për rishqyrtimin e Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin në lidhje me pjesën e kthyer për rishqyrtim nga Gjykata e Apelit, mbi bazën e Parashtrimeve të Dyta të Policisë së Kosovës dhe parashtrimeve të palëve në lidhje me to.

32. Ndonëse Mbrojtja fillimisht i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të procedonte me rishikimin e përdymuajshëm sipas nenit 41(10) të Ligjit,³⁷ më pas ajo njoftoi se do të përfshinte në kundërpërgjigjen e saj Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës.³⁸ Pra, Mbrojtja faktikisht i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të lëshonte një vendim përmbledhës ku të trajtohej rishikimi i përdymuajshëm sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe aspekti i kthyer për rishqyrtim. Si rezultat, Parashtrimet e ZPS-së janë në përputhje me Urdhrin e 8 Tetorit 2021 dhe nuk përbëjnë kundërpërgjigje shtesë. Çka është e rëndësishme, për të qenë të drejtë, edhe ZPS-së duhet t'i jepet mundësia të paraqesë komentet e saj për Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës, siç iu dha Mbrojtjes.³⁹ Gjithashtu, pas marrjes së Parashtrimeve të Mbrojtjes, kjo e fundit nuk u dëmtua sepse iu dha mundësia të paraqiste dy herë komentet e saj mbi Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës dhe Parashtrimet e ZPS-së, në përputhje me parimin e barazisë së palëve.

33. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme të sqarojë më tej natyrën e vendimit aktual. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të lëshojë një vendim përmbledhës ku do të trajtohet rishikimi i përdymuajshëm i paraburgimit të z. Veseli sipas ligjit dhe vlerësimi i aspektit të kthyer për rishqyrtim nga Gjykata e Apelit. Konkretisht, kjo do të thotë se

³⁷ Parashtrimet e 10 Tetorit 2021, para. 4.

³⁸ Transkripti i 29 Tetorit 2021, f. 711, rreshti 22 – f. 712, rreshti 2.

³⁹ Vihet re se në Përgjigje ZPS-ja informoi se synonte të paraqiste parashtrime lidhur me Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës, *shih* Përgjigja, para. 35.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të bëjë rishikimin e rregullt të paraburgimit të z. Veseli në përputhje me praktikën ekzistuese në bazë të neneve 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, ndërsa në pjesën lidhur me lirimin me kusht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të rishqyrtojë edhe Vendimin e Dytë mbi Paraburgimin sa i takon aspektit të kthyer nga Gjykata e Apelit, duke mbajtur parasysh Parashtrimet e Para dhe të Dytë të Policisë së Kosovës, Parashtrimet e ZPS-së, Parashtrimet e Zyrës Administrative dhe Parashtrimet e Mbrojtjes.

2. Kërkesë për mospërfshirja në dokumentacion

34. Mbrojtja pretendon se, edhe nëse pranohet që ZPS-ja kishte të drejtë të dorëzonte komentet e saj mbi Parashtrimet e Dytë të Policisë së Kosovës, parashtrimet e ZPS-së e tejkalojnë së tepërmi kuadrin e Kundërpërgjigjes dhe të Parashtrimeve të Dytë të Policisë së Kosovës.⁴⁰ Sipas Mbrojtjes, në vend të komenteve, ZPS-ja paraqet pretendime përgjithësuese dhe krejt të reja për korrupsion dhe veprime kriminale personalisht ndaj z. Veseli, si edhe pretendime për korrupsion dhe/ose veprime kriminale ndaj Policisë së Kosovës, sistemit gjyqësor të Kosovës, qeverisë së Kosovës, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) dhe Shërbimit Informativ të Kosovës në përgjithësi.⁴¹ Mbrojtja shton se burimet në të cilat është mbështetur ZPS-ja janë vetëm pak më shumë se thashetheme apo lajme nga faqe interneti që nuk kanë vlerë provuese.⁴² Për më tepër, sipas Mbrojtjes, koha e zgjedhur për ngritjen e këtyre pretendimeve tregon se ato janë qartazi taktike dhe nuk janë bërë ndershmërisht, pasi ky aspekt duhet të ishte ngritur që në fillim të parashtrimeve për rishikimin e paraburgimit.⁴³ Mbi këtë bazë, Mbrojtja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake që paragrafët 2-3, 5-9

⁴⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 15.

⁴¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 16, 18, 21.

⁴² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 17.

⁴³ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 19-20.

dhe 23-25 të parashtrimeve të ZPS-së të hiqen nga dokumentacioni i mos përfshihen në dokumentacionin e çështjes.⁴⁴

35. Aspekti i kthyer për rishqyrtim nga Gjykata e Apelit në lidhje me Vendimin e Dytë mbi Paraburgimin ka të bëjë me pyetjen nëse Policia e Kosovës mund të “zbatojë në mënyrë efikase” kushtet e lirit të propozuara nga Mbrojtja.⁴⁵ Krahas kësaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake veçanërisht e urdhëroi Policinë e Kosovës që të jepte informacion, ndër të tjera: (i) [REDAKTUAR]; dhe (ii) [REDAKTUAR].⁴⁶ Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, dhe pa paragjykuar vlerësimin e themelësisë së parashtrimeve të ZPS-së në këtë pikë, argumentet që synojnë të demonstrojnë ekzistencën e veprimeve kriminale ose korrupsionin, qoftë personalisht sa i takon z. Veseli apo Policisë së Kosovës ose autoriteteve të tjera në Kosovë, kanë lidhje me aspektet nën shqyrtim si dhe përfshihen në kuadrin e përgjithshëm të aspektit të kthyer për rishqyrtim nga Gjykata e Apelit dhe të pyetjeve konkrete të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

36. Sa i takon vlerës provuese të paragrafëve të kundërshtuar të Parashtrimeve të ZPS-së, ky aspekt mund të ketë lidhje me diskutimin vijues lidhur me themelësinë, por jo me atë nëse këta paragrafë duhet të hiqen nga dokumentacioni. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të përcaktojë, në qoftë se është e nevojshme, vlerën provuese që do t’u jepet pretendimeve të ZPS-së dhe, në përputhje me këtë, konstaton se Mbrojtja nuk ka arritur të demonstrojë se paragrafët në fjalë duhet të hiqen nga dokumentacioni mbi këtë bazë.

37. Gjithashtu, sa i takon kohës së paraqitjes së pretendimeve të ZPS-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se është përgjegjësi dhe e drejtë e ZPS-së që, brenda kufijve të dispozitave që rregullojnë parashtrimet e palëve, të vendosë se kur të paraqesë pretendime të caktuara në përputhje me detyrimin që ka për të

⁴⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 22, 41.

⁴⁵ Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 53.

⁴⁶ [REDAKTUAR].

demonstruar ekzistencën e arsyeve për vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarit. Kjo edhe më shumë për faktin se, siç u përmend, ZPS-ja i ka ngritur këto pretendime në lidhje me aspektin specifik që Gjykata e Apelit e ktheu për rishqyrtim dhe pyetjet përkatëse që i drejtoi Policisë së Kosovës Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Nga kjo rrjedh se nuk duhet që paragrafët e lartpërmendur të hiqen nga dokumentacioni për shkak të kohës së paraqitjes së pretendimeve në Parashtrimet e ZPS-së.

38. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hedh poshtë kërkesën e Mbrojtjes për heqjen nga dokumentacioni të paragrafëve 2-3, 5-9 dhe 23-25 të Parashtrimeve të ZPS-së.

B. STANDARDI I ZBATUESHËM

39. Mbrojtja parashtron se ndonëse Gjykata duhet të shqyrtojë secilin rast, është e pashmangshme që detyrimi për të treguar se që nga vendimi i fundit ka pasur ndryshim të rrethanave që përlligj lirimin e përkohshëm, i takon parashtruesit të kërkesës.⁴⁷

40. ZPS-ja përgjigjet se sipas rregullës 57(2) të Rregullores, vendimi nëse vazhdojnë të ekzistojnë arsyet ose rrethanat për mbajtjen në paraburgim të parapara në nenin 41 të Ligjit, lidhet në mënyrë të pashmangshme me ndryshimet, nëse ka pasur të tilla, që nga vendimi i fundit i paraburgimit.⁴⁸ ZPS-ja shton se nuk mund të pritët që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të trajtojë parashtrime që vetëm përsërisin argumentet e trajtuara tashmë në vendimet e mëparshme.⁴⁹

41. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se sipas nenit 41(10) të Ligjit, ai ka detyrimin të shqyrtojë nëse vazhdojnë të ekzistojnë arsyet për mbajtjen në

⁴⁷ Kërkesa, para. 21.

⁴⁸ Përgjigja, para. 3.

⁴⁹ Përgjigja, para. 3.

paraburgim, përfshirë arsyet e parashikuara në nenin 41(6) të Ligjit, konkretisht nëse: (i) ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer veprën ose veprat penale; dhe (ii) ka arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston ndonjë nga rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.⁵⁰ Në kuadër të detyrës për të përcaktuar nëse ende ekzistojnë rrethanat që mbështesin mbajtjen në paraburgim, paneli kompetent duhet të vlerësojë *proprio motu* nëse është ende i bindur që paraburgimi i të akuzuarit mbetet i përligjur në kohën e rishikimit dhe në rrethanat konkrete të çështjes në kohën kur kryhet rishikimi.⁵¹ Ndonëse rishikimi i rregullt çdo dy muaj sipas rregullës 57(2) të Rregullores nuk kufizohet vetëm në ndryshimin ose jo të rrethanave, një ndryshim i tillë, megjithatë, mund të jetë përcaktues dhe duhet të merret parasysh nëse ngrihet nga një palë ose *proprio motu*.⁵² Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk i kërkohet të gjykojnë mbi faktorët për të cilët tashmë është vendosur në vendimin fillestar të paraburgimit dhe as të trajtojnë parashtrime që vetëm përsërisin argumentet e trajtuara në vendimet e mëparshme.⁵³ Thelbësore është që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të jetë i bindur se në kohën e vendimit të rishikimit vazhdojnë të ekzistojnë arsyet për paraburgimin.⁵⁴ ZPS-ja ka detyrimin të vërtetojë se paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm.⁵⁵

C. DYSHIMI I BAZUAR

42. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) i Ligjit përcakton si parakusht ekzistencën e dyshimit të bazuar se është kryer vepër

⁵⁰ Shih për shembull KSC-BC-2020-07, IA002-F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 9 shkurt 2021, publik ("Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Haradinajt"), para. 55.

⁵¹ KSC-BC-2020-06, IA006-F00005/RED, Gjykata e Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit ndaj Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, publik ("Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit"), para. 15.

⁵² Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit, para. 16.

⁵³ Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Haradinajt, para. 55; Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit, para. 17.

⁵⁴ Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Haradinajt, para. 55.

⁵⁵ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 20; Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 14.

penale brenda juridiksionit të DHS-së. Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhimit të paraburgimit të personit.⁵⁶

43. Mbrojtja nuk ka bërë parashtrime lidhur me këtë kriter në Kërkesë. Në Përgjigjen e saj ZPS-ja parashtron se Gjykata e Apelit ka konfirmuar përfundimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake në Vendimin e Dytë mbi Paraburgimin se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar që z. Veseli ka kryer veprat penale brenda juridiksionit lëndor të DHS-së.⁵⁷

44. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton që në Vendimin e Konfirmimit u përcaktua se, në përputhje me nenin 39(2) të Ligjit, ekziston dyshimi i bazuar se z. Veseli ka përgjegjësi penale për një numër krimesh kundër njerëzimit (përndjekje, burgim, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë) dhe për krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit.⁵⁸ Standardi mbi të cilin u bazuan këto konstatime ishte më i lartë se sa ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas të nenit 41(6)(a) të Ligjit.⁵⁹

45. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se duke patur parasysh konstatimet e Vendimit të Konfirmimit dhe në mungesë të ndonjë zhvillimi të ri në këtë drejtim, vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Veseli ka kryer krimet në juridiksionin lëndor të DHS-së të parapara në nenin 41(6)(a) dhe (10) të Ligjit.

D. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

46. Pas përmbushjes së standardit të nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që përlligjin heqjen e lirisë së personit duhet të jenë të artikulueshme, në kuptimin që duhet të

⁵⁶ Në mënyrë të ngjashme ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222.

⁵⁷ Përgjigja, para. 1, 2, 4.

⁵⁸ Vendimi i Konfirmimit, para. 521(a); Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 24.

⁵⁹ Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 21.

specifikohen me hollësi.⁶⁰ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se bazuar në provat e disponueshme, arsyet konkrete të artikulueshme duhet të mbështesin “besimin”⁶¹ se ekziston ndonjë prej rreziqeve të parapara në secilin prej tre nënparagrafëve të nenit 41(6)(b) të Ligjit, çka nënkupton pranimin e mundësisë, e jo të pashmangshmërisë, se ato mund të ndodhin në të ardhmen.⁶² Me fjalë të tjera, standardi që duhet të zbatohet është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që rreziku të materializohet.⁶³ Gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve të parapara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.⁶⁴

1. Rreziku i arratisjes

47. Në Kërkesën e saj, Mbrojtja nuk ka bërë parashtrime në lidhje me këtë arsye të artikulueshme. Në Përgjigje, ZPS-ja parashtron se njohja gjithnjë e më shumë e z. Veseli me provat kundër tij, së bashku me mundësinë e një dënimi të rëndë në rast të shpalljes fajtor, mund t’i japë atij shtysën e nevojshme për të siguruar fonde dhe mjete për të udhëtuar dhe për t’iu shmangur procesit në DHS.⁶⁵ Ajo shton se ndikimi në vijimësi i z. Veseli në Kosovë, përfshirë edhe për shkak të funksioneve të tij të mëparshme, vërteton se ai do t’i ketë mjetet për ta bërë këtë.⁶⁶ Mbrojtja përgjigjet se nxjerrja e provave është në vetvete e pamjaftueshme për të përligjur

⁶⁰ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 21; Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 18-19.

⁶¹ *Shih pjesën e përgjithshme të nenit 41(6)(b) të Ligjit.*

⁶² Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 21.

⁶³ Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 17.

⁶⁴ KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores dhe Procedurës së Provave të Miratuara nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar*, 26 prill 2017, publik, para. 114. *Shih edhe ECtHR, Buzadji v. the Republic of Moldova [GC]*, nr. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016 (“*Buzadji v. the Republic of Moldova [GC]*”), para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia [GC]*, no. 5826/03, [Judgment](#), 22 May 2012, para. 140 *in fine*.

⁶⁵ Përgjigja, para. 7.

⁶⁶ Përgjigja, para. 7.

mohimin e lirit të përkohshëm, dhe se mungesa e provave të drejtpërdrejta të pjesëmarrjes së z. Veseli në ndonjë vepër penale konkrete vetëm e bën më pak të mundshme arratisjen.⁶⁷

48. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se z. Veseli është informuar për akuzat kundër tij dhe mundësinë e një dënimi të rëndë në rast të shpalljes fajtor.⁶⁸ Nuk ka rëndësi nëse ka apo jo prova për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të z. Veseli në ndonjë vepër penale konkrete, duke patur parasysh se, siç u përcaktua më lart, ekziston dyshimi i bazuar se z. Veseli ka kryer krime brenda juridiksionit lëndor të DHS-së, që mund të rezultojnë në një dënim me burgim të gjatë në rast se shpallet fajtor.⁶⁹ Për më tepër rikujtohet se z. Veseli vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në Kosovë, falë posteve që ka mbajtur më parë. Për këtë arsye, ndikimi që ai vazhdon të ketë si rezultat i atyre posteve – në veçanti ato të lidhura me fushën e zbulimit – mund ta ndihmojnë t'u shmanget procedurave të DHS-së, për shembull, duke kërkuar ndihmën e simpatizantëve të tij dhe/ose të UÇK-së, duke siguruar qasje në informacione të rëndësishme dhe fonde e mjete për të udhëtuar.⁷⁰

49. Bazuar në sa më sipër dhe pavarësisht nga faktorët kompensues të identifikuar në Vendimin e Parë mbi Paraburgimin,⁷¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se rreziku i arratisjes në lidhje me z. Veseli vazhdon të ekzistojë.

⁶⁷ Kundërpërgjigja, para. 5. Parashtrimet në Kundërpërgjigjen e Mbrojtjes lidhur me zvogëlimin e rrezikut të arratisjes do të trajtohen në pjesën për lirim me kusht.

⁶⁸ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 32; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 32.

⁶⁹ *Shih edhe* Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 24.

⁷⁰ Vendimi i Konfirmimit, para. 460; Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 32; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 32.

⁷¹ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 33.

2. Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

50. Mbrojtja nuk ka bërë parashtrime në lidhje me këtë arsye të artikuleshme në Kërkesë. ZPS-ja parashtron në Përgjigje se ekziston rrezik real që z. Veseli të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së në rast se do të lirohet.⁷² Sipas ZPS-së, ekziston një atmosferë e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në proceset penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së.⁷³ Më tej ZPS-ja argumenton se rreziku i pengimit të ecurisë së procesit shtohet nga njohja në rritje e të akuzuarit me provat fajësuese dhe me [REDAKTUAR], dhe se Gjykata e Apelit ka konstatuar që masat mbrojtëse në fuqi nuk janë të mjaftueshme për të zvogëluar rrezikun qenësisht të madh të frikësimit ose ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve.⁷⁴ ZPS-ja gjithashtu përmend tri raste të dëshmitarëve në procese të tjera gjyqësore të lidhura me UÇK-në të cilët u vranë ose plagosën dhe rikujton se në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*, Trupi Gjykes i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”) vërejti se shumë dëshmitarë cituan frikën si arsyen kryesore për të mos dhënë dëshmi.⁷⁵ Gjithashtu ZPS-ja është e mendimit se z. Veseli ushtron ndikim të mjaft të madh mbi ish-anëtarët e UÇK-së dhe në Kosovë në përgjithësi, ndër të tjera edhe për arsye të posteve që ka pasur në të kaluarën.⁷⁶ Së fundi, ZPS-ja argumenton se ka tregues të shumtë se ekziston rreziku që z. Veseli mund të pengojë drejtësinë, si edhe informacion që anëtarë të shërbimit të zbulimit, vartës të tij, u përfshinë në përgjimin, kërcënimin dhe ofrimin e ryshfetit dëshmitarëve që dëshmuuan kundër ish-anëtarëve të UÇK-së në proceset para TPNJ-s, dhe se është vërtetuar që z. Veseli ka aftësinë t’u japë udhëzime personave të përfshirë në ndërhyrje ndaj dëshmitarëve të mundshëm të ZPS-së.⁷⁷

⁷² Përgjigja, para. 2, 8.

⁷³ Përgjigja, para. 8.

⁷⁴ Përgjigja, para. 8, 11.

⁷⁵ Përgjigja, para. 13.

⁷⁶ Përgjigja, para. 12, 14.

⁷⁷ Përgjigja, para. 15.

51. Mbrojtja përgjigjet⁷⁸ se as Gjykata e Apelit dhe as Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kanë konstatuar se z. Veseli [REDAKTUAR].⁷⁹ Ajo shton se nuk ka prova se z. Veseli apo përkrahësit e tij kanë pasur të bëjnë apo kanë pasur lidhje me ndonjë prej tri incidenteve në të cilat kanë vdekur individë gjatë 20 viteve fundit, për të cilat ZPS-ja pretendon se janë tregues të fatit të dëshmitarëve në gjykimet e lidhura me UÇK-në.⁸⁰ Sipas Mbrojtjes, [REDAKTUAR].⁸¹ Për më tepër, Mbrojtja parashtron se në proceset e TPNJ-së të lidhura me UÇK-në nuk pati asnjë dëshmitar të vrarë dhe, ndonëse dëshmitarët ngurronin të paraqiteshin në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*, në përfundim ata të gjithë dëshmuan në gjykim ose rigjykim.⁸²

52. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se është konstatuar që z. Veseli ka aftësinë t'i japë udhëzime një personi që kishte punë me DHS-në dhe, duke e bërë këtë, ai ndërhyri drejtpërsëdrejti në një çështje që ka të bëjë me DHS-në.⁸³ Përveç kësaj, siç u përmend, z. Veseli vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në Kosovë falë posteve të tij të mëparshme,⁸⁴ çka do të vazhdojë t'i mundësojë, për shembull, që të ketë qasje në informacion ose të kërkojë mbështetje nga të tjerët.⁸⁵ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se provat tregojnë që gjatë kohës kur z. Veseli ishte në krye të shërbimit të zbulimit nga viti 1999 deri në vitin 2008,⁸⁶ [REDAKTUAR], anëtarët e shërbimit të zbulimit u përfshinë në: (i) [REDAKTUAR], ndër të tjera duke kërcënuar [REDAKTUAR] një dëshmitar [REDAKTUAR]; dhe (ii) ndjekjen [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për të

⁷⁸ Parashtrimet në Kundërpërgjigjen e Mbrojtjes lidhur me zvogëlimin e rrezikut të pengimit të procesit do të trajtohen në pjesën për lirimim me kusht.

⁷⁹ [REDAKTUAR].

⁸⁰ Kundërpërgjigjja, para. 23-25.

⁸¹ [REDAKTUAR].

⁸² Kundërpërgjigjja, para. 26-27.

⁸³ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 44; Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 38; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 35; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 34.

⁸⁴ *Shih* para. 48 më lart.

⁸⁵ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 43; Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 40; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 35; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 34.

⁸⁶ [REDAKTUAR].

zbuluar [REDAKTUAR], si dhe kërcënimin [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].⁸⁷ Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, këto incidente janë shembuj të rrezikut se së bashku me ndërhyrjen e vërtetuar të tij në një çështje të lidhur me DHS-në duke i dhënë udhëzime një individ, z. Veseli mund të ushtrojë ndikim në Kosovë për pengimin e proceseve të DHS-së.

53. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton gjithashtu se masat mbrojtëse në fuqi nuk janë plotësisht të mjaftueshme për të zvogëluar rrezikun e pengimit të procesit të përmendur në konstatimet e mëparshme, duke pasur parasysh se me gjithë lëshimin e vendimeve shtesë mbi masat mbrojtëse pas Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin,⁸⁸ [REDAKTUAR] dhe se, me gjithë këto masa, zotit Veseli [REDAKTUAR].⁸⁹ Mbi këtë bazë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin gjithashtu në përfundimin se, duke pasur parasysh se është vërtetuar që z. Veseli ka ndërhyrë në një çështje që lidhet me DHS-në dhe se ai vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në Kosovë, njohja e tij gjithnjë e më e madhe me provat në të cilat mbështeten

⁸⁷ Vendimi për Fletarrestimet, para. 33; [REDAKTUAR]; KSC-BC-2020-06, F00005/RED, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Publik i 'Kërkesës për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave në lidhje me To', parashtrimi KSC-BC-2020-06/F00005 i datës 28 maj 2020*, publik, me shtojcën e redaktuar publike 1 dhe shtojcat publike 2-3, para. 8.

⁸⁸ KSC-BC-2020-06, F00407, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Shtatë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 21 korrik 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (një version konfidencial i redaktuar u lëshua në të njëjtën ditë, F00407/CONF/RED); F00438, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Tetë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 24 gusht 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua në të njëjtën ditë, F00438/CONF/RED); F00466, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Nëntë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 13 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua në të njëjtën ditë, F00466/CONF/RED); F00467, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dhjetë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 13 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua në të njëjtën ditë, F00467/CONF/RED); F00559, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Njëmbëdhjetë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 5 nëntor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00571, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dymbëdhjetë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 17 nëntor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një variant i redaktuar konfidencial u lëshua në të njëjtën ditë).

⁸⁹ [REDAKTUAR].

akuzat e rënda kundër tij pas Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin e rrit rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit.⁹⁰

54. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rithekson se në Kosovë ekziston një atmosferë e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve dhe e ndërhyrjes në proceset penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së që, edhe pse në vetvete nuk është faktor përcaktues, përbën kontekstin në të cilin duhet të shqyrtohen konstatimet e lartpërmendura që lidhen posaçërisht me z. Veseli.⁹¹ Gjithashtu, nuk është e nevojshme që rreziku i pengimit të procesit të materializohet nëpërmjet manipulimit të provave personalisht nga i akuzuari apo ushtrimit prej tij të ndikimit ose trysnisë mbi dëshmitarët, pasi mjafton që i akuzuari të nxisë persona të tjerë ose të kontribuojë në ndonjë mënyrë tjetër në materializimin e atij rreziku.⁹²

55. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, arrin në përfundimin se në kontekstin e përgjithshëm të atmosferës së vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në proceset penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së në Kosovë, vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Veseli të pengojë ecurinë e proceseve të DHS-së, që bazohet në vlerësimet e gatishmërisë dhe aftësisë që ka treguar ai për të ndërhyrë në çështje që kanë të bëjnë me DHS-në, të aftësisë së tij për të siguruar mjete për të ndërhyrë në procedurat e DHS-së në sajë të rolit të tij të rëndësishëm në vijimësi, dhe të njohjes gjithnjë e më shumë me provat. Duke pasur parasysh këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, ndonëse Mbrojtja parashtron me të drejtë se nuk është konstatuar që z. Veseli [REDAKTUAR], nuk është e nevojshme që ai të shqyrtojë më tej këtë argument apo parashtrimet e palëve për ngjarje që kanë të bëjnë me dëshmitarët në procese të tjera të lidhura me UÇK-në.

⁹⁰ *Shih edhe* Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 31-33.

⁹¹ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 48; Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 40, 48; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 36.

⁹² KSC-BC-2020-06, IA003/F00005/RED, Gjykata e Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 59.

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

56. Në Kërkesën e tij, z. Veseli nuk bën parashtrime në lidhje me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera. ZPS-ja në Përgjigje argumenton se ky rrezik duhet parë në kuadër të: (i) atmosferës së rrënjosur dhe të vazhdueshme të frikësimit dhe të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve; (ii) njohjes gjithnjë e më shumë të të akuzuarit me provat fajësuese; dhe (iii) pozitës së rëndësishme me ndikim që i akuzuari ende ka në Kosovë.⁹³ ZPS-ja pretendon se [REDAKTUAR].⁹⁴ Mbrojtja përgjigjet se [REDAKTUAR].⁹⁵

57. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, edhe pse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, në rrethanat e çështjes aktuale faktorët mbi të cilët bazohet rreziku i parë janë me rëndësi edhe për vlerësimin e këtij të fundit.⁹⁶ Ai rikujton gjithashtu se është e mjaftueshme që i akuzuari të nxisë ose ndihmojë të tjerët në kryerjen e krimeve të tilla, ose të kontribuojë në çfarëdo mënyre tjetër në kryerjen e tyre.⁹⁷

58. Duke iu kthyer fakteve nën shqyrtim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton fillimisht se, [REDAKTUAR]. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se krahas atmosferës mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve z. Veseli: (i) ka aftësinë dhe gatishmërinë e vërtetuar për të ndërhyrë në proceset e DHS-së; (ii) ka aftësinë të sigurojë mjetet për të ndërhyrë në proceset e DHS-së për shkak se vazhdon të ketë rol me rëndësi në Kosovë; dhe (iii) që nga Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, është njohur më shumë me provat e ZPS-së

⁹³ Përgjigjja, para. 23.

⁹⁴ [REDAKTUAR].

⁹⁵ [REDAKTUAR]. Parashtrimet e mëtejshme në Kundërpërgjigjen e Mbrojtjes lidhur me zvogëlimin e rrezikut të kryerjes së krimeve të tjera do të trajtohen në pjesën për lirim me kusht.

⁹⁶ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 52; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 39.

⁹⁷ Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 25, 52; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 39.

kundër tij si rezultat i nxjerrjes në vijimësi të materialeve që mbështesin akuzat e rënda kundër tij.⁹⁸

59. Mbi këtë bazë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se ekziston rreziku që z. Veseli do të kryejë, sipas cilësdo forme të përgjegjësisë, krime të ngjashme me krimet bazë për të cilat akuzohet, kundër atyre që konsiderohen si kundërshtarë të UÇK-së, ku përfshihen edhe dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose që pritet të paraqiten para DHS-së.

60. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Veseli të kryejë krime të tjera.

4. Përfundim

61. Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Veseli të arratiset, të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së ose të kryejë krime të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose pritet të paraqiten para DHS-së. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim do të vlerësojë nëse këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm përmes ndonjë prej kushteve për lirimin e tij.

E. LIRIMI ME KUSHT

1. Parashtrimet

(a) Kërkesa

62. Mbrojtja argumenton se në Parashtrimet e Para të Policisë së Kosovës, [REDAKTUAR] Policia e Kosovës është një organizatë profesionale e zbatimit të

⁹⁸ *Shih* para. 48, 52-54 më lart.

ligjit, e gatshme të zbatojë vendimet e DHS-së.⁹⁹ Mbrojtja gjithashtu parashtron se masat e propozuara janë gjithëpërfshirëse dhe efektive.¹⁰⁰

63. Në lidhje me rrezikun e komunikimit të fshehtë e të pambikëqyrur, Mbrojtja është e mendimit se Policia e Kosovës është po aq – në mos më mirë – e pajisur për të zbatuar masat e sigurisë që ekzistojnë në objektin e paraburgimit të DHS-së, duke pasur parasysh se: (i) [REDAKTUAR]; dhe (ii) [REDAKTUAR].¹⁰¹ Mbrojtja shton se në ndryshim nga objekti i paraburgimit i DHS-së, [REDAKTUAR].¹⁰²

(b) Përgjigjja

64. ZPS-ja përgjigjet se asnjë prej kushteve të lirimit në Kosovë nuk mund të zvogëlojë rreziqet e veçanta në fjalë.¹⁰³ Sipas saj, Gjykata e Apelit nuk e trajtoi pyetjen nëse këto kushte mundësojnë kufizim dhe monitorim të mjaftueshëm të komunikimeve për të përligjur lirin me kusht; në vend të kësaj, ajo arsyetoi se nevojitet informacion i mëtejshëm.¹⁰⁴ Sipas ZPS-së, analiza e kushteve të domosdoshme duhet të marrë parasysh atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë – përfshirë ndërhyrjet që janë bërë deri më sot në këtë çështje – dhe ndikimin e të akuzuarve në Kosovë.¹⁰⁵

65. Më tej ZPS-ja parashtron se garancitë e ofruara në Parashtrimet e Para të Policisë së Kosovës mbeten të pamjaftueshme,¹⁰⁶ duke qenë se: (i) [REDAKTUAR];¹⁰⁷ (ii) [REDAKTUAR];¹⁰⁸ (iii) [REDAKTUAR];¹⁰⁹ dhe

⁹⁹ [REDAKTUAR].

¹⁰⁰ Kërkesa, para. 31.

¹⁰¹ [REDAKTUAR].

¹⁰² [REDAKTUAR].

¹⁰³ Përgjigjja, para. 24.

¹⁰⁴ Përgjigjja, para. 24.

¹⁰⁵ Përgjigjja, para. 25, 34.

¹⁰⁶ Përgjigjja, para. 25, 31.

¹⁰⁷ [REDAKTUAR].

¹⁰⁸ [REDAKTUAR].

¹⁰⁹ [REDAKTUAR].

(iv) [REDAKTUAR].¹¹⁰ Përveç kësaj, ZPS-ja mendon se në të tre rastet Policia e Kosovës nuk ka dhënë përgjigje të mjaftueshme, çka vë në dyshim të kuptuarit e rreziqeve dhe gatishmërinë dhe aftësinë e saj për të zbatuar në mënyrë të mjaftueshme kushtet e lirimit.¹¹¹

66. ZPS-ja shton se është e qartë që Mbrojtja dhe Policia e Kosovës po bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për hartimin në vijimësi të këtyre përgjigjeve lidhur me lirimin me kusht, por ende mbetet pa përgjigje aspekti i zbatimit praktik të tyre.¹¹²

(c) Kundërpërgjigjja

67. Mbrojtja kundërpërgjigjet se konstatimi se rreziku i arratisjes zvogëlohet me anë të arrestit shtëpiak duhet të mbetet i pandryshuar dhe se Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës e përforcojnë edhe më tej zvogëlimin e konstatuar të këtij rreziku.¹¹³

68. Në lidhje me pengimin e procesit, Mbrojtja thekson se garancitë e ofruara e zvogëlojnë plotësisht këtë rrezik.¹¹⁴ Në veçanti, Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës trajtojnë konkretisht rrezikun që z. Veseli mund t'i përcjellë mesazhe dikujt personalisht ose të përdorë gjuhë të koduar, përmes masave të ngjashme me protokollet e përdorura në objektin e paraburgimit të DHS-së: (i) [REDAKTUAR]; (ii) [REDAKTUAR]; (iii) [REDAKTUAR]; dhe (iv) [REDAKTUAR].¹¹⁵ Ajo shton se Policia e Kosovës ka epërsinë shtesë se e njeh mirë gjuhën amtare të të akuzuarit dhe [REDAKTUAR].¹¹⁶

¹¹⁰ [REDAKTUAR].

¹¹¹ Përgjigjja, para. 32-33.

¹¹² Përgjigjja, para. 33.

¹¹³ Kundërpërgjigjja, para. 5-6.

¹¹⁴ Kundërpërgjigjja, para. 8.

¹¹⁵ [REDAKTUAR].

¹¹⁶ [REDAKTUAR].

69. Mbrojtja më tej argumenton se arsyet e paraqitura nga ZPS-ja se pse garancitë e ofruara në Parashtrimet e Para të Policisë së Kosovës janë të pamjaftueshme për zvogëlimin e rrezikut, keqkuptojnë premisën se Policia e Kosovës është e gatshme dhe e aftë të zbatojë çdo urdhër të dhënë nga DHS-ja.¹¹⁷ Në lidhje me arsyet konkrete të përmendura nga ZPS-ja, Mbrojtja shton se Parashtrimet e Dytë të Policisë së Kosovës vërtetojnë se Policia e Kosovës: (i) ka kapacitetet njerëzore dhe pajisjet teknologjike të nevojshme për punën; (ii) [REDAKTUAR]; (iii) u përgjigjen drejtpërsëdrejti shqetësimeve lidhur me kufizimin e mjeteve të komunikimit; dhe (iv) ka njësi të specializuara për të zbatuar urdhrat e Gjykatës, përvoja të mëparshme të drejtpërdrejta, dhe ka konfirmuar aftësinë e saj për të zbatuar çdo urdhër që DHS-ja e konsideron të nevojshëm.¹¹⁸ Mbrojtja gjithashtu thekson se nuk ka asnjë arsye që përlligj nënvlerësimin e shprehur nga ZPS-ja për propozimet e sigurisë të paraqitura nga Policia e Kosovës.¹¹⁹

70. Së fundi, Mbrojtja argumenton se pretendimet e ZPS-së se Mbrojtja ka bashkëpunuar me Policinë e Kosovës janë keqinterpretime sepse: (i) në dy raste të mëhershme, Mbrojtja nuk mori përgjigjen që kishte kërkuar nga Policia e Kosovës; dhe (ii) ajo në vijim i kërkoi Policisë së Kosovës përgjigje më të hollësishme.¹²⁰

(d) Parashtrimet e ZPS-së

71. ZPS-ja parashtron se kushtet e propozuara nuk janë të mjaftueshme dhe, edhe nëse do të ishin, Policia e Kosovës nuk mund t'i zbatojë ato në mënyrë efektive.¹²¹

¹¹⁷ Kundërpërgjigjja, para. 12.

¹¹⁸ [REDAKTUAR].

¹¹⁹ Kundërpërgjigjja, para. 17-18.

¹²⁰ Kundërpërgjigjja, para. 28-31.

¹²¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 4, 27.

72. Sipas ZPS-së, atmosfera e përgjithshme e ndërhyrjeve në procesin gjyqësor në Kosovë nuk është relikti historik.¹²² Ajo shton se [REDAKTUAR].¹²³ ZPS-ja më tej parashtron se [REDAKTUAR].¹²⁴

73. ZPS-ja gjithashtu parashtron se [REDAKTUAR].¹²⁵ Ajo shton se ka artikuj në media për ndikimin e ish-anëtarëve të Shërbimit Informativ të Kosovës mbi Policinë e Kosovës.¹²⁶ Për më tepër, sipas ZPS-së, korrupsioni brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës njihet gjerësisht.¹²⁷

74. Krahas kësaj, në pikëpamjen e ZPS-së, Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës nuk shtojnë garanci të njëmendta përtej atyre që ZPS-ja i ka trajtuar më parë: (i) [REDAKTUAR];¹²⁸ (ii) [REDAKTUAR];¹²⁹ (iii) [REDAKTUAR];¹³⁰ dhe (iv) [REDAKTUAR].¹³¹

75. Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se Policia e Kosovës nuk mund të zbatojë në mënyrë efektive kushtet e lirimit të përkohshëm duke qenë se: (i) edhe pas katër përpjekjesh, ajo nuk ka arritur të demonstrojë se është e gatshme dhe e aftë që të zbatojë kushte të mjaftueshme lirimi;¹³² (ii) figura të njohura në udhëheqjen e Policisë së Kosovës kanë lidhje me UÇK-në;¹³³ dhe (iii) z. Veseli vazhdon të ketë ndikim shumë të madh.¹³⁴

¹²² Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

¹²³ [REDAKTUAR].

¹²⁴ [REDAKTUAR].

¹²⁵ [REDAKTUAR].

¹²⁶ Parashtrimet e ZPS-së para. 5.

¹²⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 7.

¹²⁸ [REDAKTUAR].

¹²⁹ [REDAKTUAR].

¹³⁰ [REDAKTUAR].

¹³¹ [REDAKTUAR].

¹³² Parashtrimet e ZPS-së, para. 21-22.

¹³³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 23-24.

¹³⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 3, 25.

(e) Parashtrimet e Mbrojtjes

76. Mbrojtja parashtron se ZPS-ja nuk ka trajtuar aspak kohëzgjatjen e paraburgimit të z. Veseli, vonesat e shkaktuara nga ZPS-ja, afatet që ajo nuk i ka zbatuar dhe, çka është më shqetësuese, keqinterpretimet e saj.¹³⁵

77. Ajo shton se argumenti i vjetër i ZPS-së se perceptimi i publikut rreth lirimit të z. Veseli do të shkaktonte frikë dhe pasiguri të përgjithshme tek dëshmitarët hidhet poshtë drejtpërsëdrejti nga një vendim i TPNJ-së në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*, ku thuhet se frika dhe pasiguria e përgjithshme nuk janë arsye të mjaftueshme për të mohuar lirinë me kusht.¹³⁶ Mbrojtja më tej argumenton se mund të deduktohet që argumenti i ZPS-së është rrëzuar, sepse nuk u trajtua në vendimet e mëparshme të Gjykatës të Procedurës Paraprake për rishikimin e paraburgimit.¹³⁷ Ajo gjithashtu pretendon se është e palejueshme që ZPS-ja ta ngrejë këtë aspekt, sepse nuk e ka bërë këtë më parë gjatë debateve juridike në këtë çështje gjyqësore dhe ai nuk ka asnjë lidhje me Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës.¹³⁸

78. Gjithashtu, sipas Mbrojtjes, parashtrimet e ZPS-së mbi Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës në thelb përmbledhen në: (i) një kritikë pedante të kapaciteteve që Policia e Kosovës i ka renditur specifikisht, sepse Policia e Kosovës ka konfirmuar që i ka të gjitha kapacitetet e nevojshme për të zbatuar me sukses urdhrin e DHS-së;¹³⁹ (ii) akuza të padrejta se përgjigjeve u mungon konkretësia, ose se janë të paqarta e të mjegullta dhe, në rast të tillë, i takon DHS-së të kërkojë sqarime të mëtejshme;¹⁴⁰ dhe (iii) pretendime të përgjithshme për paaftësi dhe korrupsion të cilat janë të papërligjura, taktike, dhe nuk mbështeten nga provat –

¹³⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 24-25.

¹³⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 26-28.

¹³⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 29.

¹³⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 30.

¹³⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 31-34.

¹⁴⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 31, 35-37.

sikurse ilustruhet edhe nga fakti që ZPS-ja i referohet Policisë së Kosovës kur i volit për argumentet e saj – dhe të cilat kundërshtohen nga shembulli i lirit me kusht të Ramush Haradinajt (“z. Haradinaj”).¹⁴¹

2. Diskutim

(a) Rreziku i arratisjes

79. Siç konstatohet në Vendimin e Parë dhe Vendimin e Dytë mbi Paraburgimin, rreziku i arratisjes mund të zvogëlohet në mënyrë të mjaftueshme bazuar në zotimin e z. Veseli se do të qëndrojë në arrest shtëpiak, do të dorëzojë dokumentet e udhëtimit dhe do të respektojë ndalimin e udhëtimit.¹⁴² Ky përfundim mbështetet nga garancitë e dhëna nga Policia e Kosovës se [REDAKTUAR].¹⁴³

(b) Rreziku i pengimit të procesit dhe kryerjes së krimeve të tjera

80. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Gjykata e Apelit vendosi se, ndonëse lista e kushteve të propozuara nga Mbrojtja në lidhje me Vendimin e Dytë mbi Paraburgimin ishte e hollësishme dhe teorikisht mund mundësojnë kufizimin dhe monitorimin e komunikimeve të tij, mbetet për t’u vlerësuar nëse këto masa mund të zbatohen në mënyrë efektive nga Policia e Kosovës.¹⁴⁴ Rrjedhimisht, në bazë të informacionit në Parashtrimet e Para dhe të Dytë të Policisë së Kosovës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të vlerësojë: (i) nëse kushtet mund t’i zvogëlojnë mjaftueshëm këto rreziqe; dhe (ii) nëse Policia e Kosovës i ka kapacitetet për të zbatuar në mënyrë efektive kushtet nën shqyrtim,

¹⁴¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 31, 38-40.

¹⁴² Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 58; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 46.

¹⁴³ [REDAKTUAR].

¹⁴⁴ Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 48-53.

duke pasur parasysh rrezikun se z. Veseli do të pengojë procesin e DHS-së dhe/ose do të kryejë krime të tjera.

(i) Monitorimi i komunikimeve me anëtarët e familjes dhe vizitorët e miratuar paraprakisht

81. Policia e Kosovës parashtron se [REDAKTUAR].¹⁴⁵ Gjithashtu, Policia e Kosovës është e përgatitur [REDAKTUAR].¹⁴⁶ Nga ana tjetër, Policia e Kosovës specifikon se [REDAKTUAR].¹⁴⁷

82. Sa i takon komunikimit me anëtarët e familjes në veçanti, kjo do të thotë se [REDAKTUAR]. Përveç kësaj, z. Veseli mund të përdorë gjuhë të fshehtë ose të koduar të cilën [REDAKTUAR]. Rrjedhimisht, këto kushte nuk trajtojnë mundësinë që [REDAKTUAR], z Veseli mund t'i kërkojë një anëtar të familjes të përcjellë një mesazh gojarisht ose të përdorë për këtë një pajisje që i përket një personi të tretë,¹⁴⁸ ose që ai mund të përcjellë mesazhe të fshehta me qëllim pengimin e procedurave të DHS-së ose kryerjen e krimeve të tjera. Të njëjtat argumente vlejnë edhe për vizitat e monitoruara me vizitorët e miratuar paraprakisht, sidomos sa i takon mundësisë së përdorimit të gjuhës së koduar ose të fshehtë [REDAKTUAR]. Ky rrezik shtohet edhe më tej për shkak të përvojës së z. Veseli në poste të lidhura me zbulimin.

83. Në ndryshim nga sa më lart, komunikimet e pamonitoruara në objektin e paraburgimit të DHS-së janë rreptësisht të kufizuara, duke pasur parasysh se të ndaluarve u lejohen "vizita private" të pamonitoruara vetëm me disa anëtarë të familjes së ngushtë dhe për periudha të kufizuara kohe.¹⁴⁹ Gjithashtu, vizitat personale ose nëpërmjet videolidhjes si rregull kryhen brenda rrezes së shikimit

¹⁴⁵ [REDAKTUAR].

¹⁴⁶ [REDAKTUAR].

¹⁴⁷ [REDAKTUAR].

¹⁴⁸ Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 48.

¹⁴⁹ Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, poshtëshënimi 95.

dhe dëgjimit të oficerëve të paraburgimit të DHS-së.¹⁵⁰ Administratorja mund të vendosë masa sigurie shtesë për këto vizita, përfshirë monitorimin aktiv dhe dëgjimin pas vizitës.¹⁵¹ Kjo bën të mundur që vizitat të këqyren më vonë, ndërsa vizitat me monitorim aktiv mund të ndërpriten menjëherë, për shembull, për të parandaluar nxjerrjen e paautorizuar të informacionit konfidencial – nëse mendohet se i ndaluari po përdor gjuhë të koduar – apo ndërhyrjen në zhvillimin e sigurt të procesit.¹⁵²

84. Gjithashtu, sipas neneve 34(8) dhe (12) të Ligjit, Zyra Administrative e DHS-së është përgjegjëse për drejtimin dhe administrimin e paraburgimit dhe të objektit të paraburgimit në emër të DHS-së, si dhe [REDAKTUAR].¹⁵³ Rrjedhimisht, Zyra Administrative ka pozitën unike për drejtimin dhe administrimin e objektit të paraburgimit të DHS-së, [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].¹⁵⁴

85. Është me rëndësi të theksohet se në ndryshim nga banesa private e z. Veseli, objekti i paraburgimit i DHS-së është një mjedis i sigurisë së lartë.¹⁵⁵ Mbi të gjitha, oficerët e paraburgimit të DHS-së janë të kualifikuar, [REDAKTUAR] dhe trajnohen për zbatimin e sistemit të vizitave dhe komunikimit në objektin e paraburgimit të DHS-së.¹⁵⁶

86. Policia e Kosovës [REDAKTUAR]. Gjithashtu, sipas Gjykatësit të Procedurës Paraprake, është vendimtar fakti që [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka arritur në këtë përfundim sepse: (i) [REDAKTUAR]; (ii) [REDAKTUAR];¹⁵⁷ dhe (iii) [REDAKTUAR].

¹⁵⁰ Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 31; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 47, poshtëshënimi 95.

¹⁵¹ Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 32.

¹⁵² Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 32-33.

¹⁵³ [REDAKTUAR].

¹⁵⁴ [REDAKTUAR].

¹⁵⁵ Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 43.

¹⁵⁶ [REDAKTUAR].

¹⁵⁷ [REDAKTUAR].

87. [REDAKTUAR].¹⁵⁸ [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].
[REDAKTUAR].¹⁵⁹

88. Gjithashtu, fakti që punonjësit e Policisë së Kosovës flasin gjuhën amtare të z. Veseli dhe mund ta njohin kontekstin e përgjithshëm në Kosovë, sikurse nënvizon Mbrojtja,¹⁶⁰ nuk mjafton për të garantuar monitorimin e efektshëm të vizitave dhe komunikimeve, duke pasur parasysh, [REDAKTUAR].

89. Si përfundim, ndonëse rreziku i mesazheve dhe udhëzimeve të paligjshme nuk mund të eliminohet plotësisht, masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të para në tërësi, përbëjnë garanci të forta lidhur me vizitat dhe komunikimet e pamonitoruara me anëtarët e familjes dhe vizitorët e miratuar paraprakisht, me qëllim minimizimin e pengimit të ecurisë së procesit dhe kryerjes së krimeve të tjera.¹⁶¹ Sipas Gjykatësit të Procedurës Paraprake, Policia e Kosovës nuk ka dhënë garanci se ka aftësinë të zbatojë masat përkatëse që minimizojnë mjaftueshmërisht rreziqet ekzistuese.

(ii) Faktorët kontekstualë

90. [REDAKTUAR].¹⁶² Gjithashtu, me gjithë kërkesën e Gjykatësit të Procedurës Paraprake që Policia e Kosovës të kontaktonte institucione të tjera në Kosovë,¹⁶³ [REDAKTUAR].¹⁶⁴ [REDAKTUAR].¹⁶⁵

¹⁵⁸ [REDAKTUAR].

¹⁵⁹ [REDAKTUAR].

¹⁶⁰ Kundërpërgjigjja, para. 11.

¹⁶¹ *Në mënyrë të ngjashme* KSC-BC-2020-06, IA010/F00008/RED, Gjykata e Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit*, 27 tetor 2021, publik ("Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit"), para. 68.

¹⁶² [REDAKTUAR].

¹⁶³ Urdhri për Policinë e Kosovës, para. 9.

¹⁶⁴ [REDAKTUAR].

¹⁶⁵ [REDAKTUAR].

91. Në lidhje me këtë, Mbrojta parashtron se lirimi me kusht i z. Haradinaj u krye pa vështirësi.¹⁶⁶ Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja citon nga një vendim që rrëzoi kërkesën për lirim të përkohshëm me arsyetimin se, duke pasur parasysh frikën e shprehur nga dëshmitarët lidhur me dhënien e dëshmisë, nevoja për të siguruar integritetin e procesit kishte më shumë peshë se interesat e z. Haradinaj.¹⁶⁷ Gjithsesi, ndonëse z. Haradinaj u lirua para fillimit të gjyqimit të tij në TPNJ,¹⁶⁸ kushtet e liritimit të tij u zbatuan nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe jo nga Policia e Kosovës.¹⁶⁹ Për këtë arsye, përveç faktit që çdo çështje duhet vlerësuar individualisht, çështja e z. Haradinaj në TPNJ dallon nga propozimi për lirim me kusht të z. Veseli.

92. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, është i mendimit se nuk është demonstruar mjaftueshëm se Policia e Kosovës ka përvojë të gjatë dhe të pranuar në zbatimin e kushteve të liritimit me kusht të individëve të akuzuar për krime të rënda (të cilët mbajnë, ose kanë mbajtur më parë, poste të larta).

93. Përveç kësaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se [REDAKTUAR].¹⁷⁰ Ky është një fakt objektiv që vendos lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet Policisë së Kosovës dhe sektorit të zbulimit në Kosovë. Bazuar në këtë fakt, ekziston një mundësi reale që z. Veseli të përdorë ndikimin e tij të provuar në Kosovë – të fituar, ndër të tjera, si rezultat i posteve të tij në sektorin e zbulimit – për t’iu shmangur kushteve të arrestit shtëpiak. Kjo është edhe më e vërtetë kur merret parasysh se, siç u përmend, anëtarët e shërbimit të zbulimit u përfshinë në

¹⁶⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 39.

¹⁶⁷ ICTY, *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84-T, [Vendim mbi Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm](#), 20 korrik 2007 (“Vendimi Haradinaj i 20 korrikut 2007”), para. 24-30.

¹⁶⁸ ICTY, *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84-PT, [Vendim mbi Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm](#), 6 qershor 2005 (“Vendimi Haradinaj i 6 qershorit 2005”), para. 53.

¹⁶⁹ [Vendimi Haradinaj i 6 qershorit 2005](#), para. 37-43, 51, 53, 54; [Vendimi Haradinaj i 20 korrikut 2007](#), para. 15.

¹⁷⁰ [REDAKTUAR]

ndërhyrjet ndaj dëshmitarëve [REDAKTUAR] në TPNJ gjatë kohës që z. Veseli ishte kreu i shërbimit të zbulimit.¹⁷¹

94. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se arsyeja e themelimit të DHS-së ishte që proceset penale kundër ish-anëtarëve (me rang të lartë) të UÇK-së të mos zhvilloheshin në Kosovë.¹⁷² Si rezultat, këto procese u vendosën jashtë Kosovës,¹⁷³ dhe kuadri procedural dhe praktikat operative të DHS-së kanë si qëllim të garantojnë, në shkallën më të lartë të mundshme, mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave dhe të tjerëve me qëllim zbatimin e mandatit të DHS-së. Për më tepër, siç u përmend, ekziston një atmosferë e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjeve në proceset penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së në Kosovë.¹⁷⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se shumë organizata ndërkombëtare kanë dokumentuar kohët e fundit se sektori i drejtësisë penale në Kosovë vazhdon të jetë i ndikuar nga korrupsioni.¹⁷⁵

¹⁷¹ *Shih* para. 52 më lart.

¹⁷² Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, Komisioni për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, *Raport: Trajtimi Çnjerëzor i Personave dhe Trafikimi i Paligjshëm i Organeve Njerëzore në Kosovë*, Doc. 12462, 7 janar 2011, para. 10.

¹⁷³ Ligji Nr. 04/L-274, f. 8-9 (Nëse hetimi i SITF-së rezulton në aktakuzë dhe procese gjyqësore, duhet të sigurohet një mjedis i përshtatshëm për administrimin e duhur të drejtësisë. Në pajtim me këtë, proceset gjyqësore dhe të apelit që do të vijojnë si rezultat i hetimeve të SITF-së do të kryhen nga një gjykatë e specializuar brenda sistemit gjyqësor të Kosovës si dhe nga zyra e një prokurori të specializuar. Kjo gjykatë do të ketë një degë në Kosovë, por procedurat e ndjeshme, ndër të cilat dhënia e dëshmive nga dëshmitarët, do të kryhen jashtë vendit, për shkak të natyrës së pretendimeve); Marrëveshja midis Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Kosovës në lidhje me Vendosjen e Selisë së Institucionit Gjyqësor të Specializuar të Zhvendosur të Kosovës në Holandë, 15 shkurt 2016, Parathënie ("Duke iu referuar shkëmbimit të letrave mes Presidentes së Republikës së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe të Sigurisë të datës 14 prill 2014, ratifikuar me Ligjin e Kosovës nr. 04/L-274 të 15 majit 2014, i cili përmban angazhimin e Republikës së Kosovës për themelimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar brenda sistemit gjyqësor të Kosovës për kryerjen e gjykimeve dhe apeleve që do të rezultojnë nga hetimet e Task Forcës Hetimore Speciale të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në lidhje me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës Doc. 12462 të 7 janarit 2011, dhe të cilat mund të zhvendosen në një shtet të tretë në varësi të lidhjes së një marrëveshjeje me shtetin pritës"), neni 3 ("Institucioni Gjyqësor i Specializuar i Zhvendosur i Kosovës ka një seli në shtetin pritës").

¹⁷⁴ *Shih* para. 54 më lart.

¹⁷⁵ UNMIK, *Report of the Secretary-General*, U.N.Doc. S/2020/964, 1 October 2020, para. 30; European Union Rule of Law Mission, *Justice Monitoring Report*, October 2020, f. 21; European Commission, *Kosovo Report 2021*, 19 October 2021, f. 23, 25.

95. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se faktorët e lartpërmendur nuk janë në vetvete vendimtarë për aspektin nën shqyrtim. Gjithsesi, vlerësimi i kushteve të arrestit shtëpiak që do të zbatohen nga Policia e Kosovës nuk mund të shkëputet nga konteksti në të cilin do të bëhet arresti shtëpiak, duke pasur parasysh ndikimin që ka ai në zhvillimin e procedurave para DHS-së. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se mbi bazën e treguesve bindës të paraqitur më lart, konteksti i kryerjes së arrestit shtëpiak përforcon përfundimin se masat e propozuara nuk do të zvogëlonin mjaftueshëm rrezikun e pengimit të procesit dhe/ose kryerjen e krimeve të tjera, sa i takon posaçërisht z. Veseli.

(iii) Masat shtesë

96. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktin se Policia e Kosovës zotohet në përgjithësi që të garantojë zbatimin e rreptë të vendimeve të DHS-së.¹⁷⁶ Gjithsesi, ky zotim nuk është i mjaftueshëm që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të urdhërojë *proprio motu* masa shtesë për zvogëlimin e rreziqeve të identifikuara. Duke pasur parasysh urdhrin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për dhënien e informacioneve konkrete në përgjigje të pyetjeve të hollësishme, si dhe të çfarëdo informacioni tjetër relevant (në veçanti në lidhje me masat shtesë që do të zbatonte Policia e Kosovës),¹⁷⁷ ky zotim i përgjithshëm, në vetvete, nuk përbën pranim se masat e urdhëruara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të zbatohen në mënyrë të mjaftueshme, e aq më pak garanci se mund të zbuten shqetësimet themelore për komunikimet e paligjshme që u shtjelluan më lart.

97. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk ka bazë për të kërkuar informacion të mëtejshëm nga Policia e Kosovës. Policia e Kosovës u kontaktua tri herë nga Mbrojtja dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake formuloi një

¹⁷⁶ Parashtrimet e Para të Policisë së Kosovës, f. 8; Parashtrimet e Dyta të Policisë së Kosovës, f. 1-2; Kërkesa, para. 29-30; Kundërpërgjigja, para. 12; Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 31-34.

¹⁷⁷ Urdhri për Policinë e Kosovës, para. 8; Shtojca e Urdhrit për Policinë e Kosovës, para. 12.

listë të detajuar pyetjesh, gjithashtu për t'i dhënë Policisë së Kosovës mundësinë të jepte informacione shtesë që i konsideronte të rëndësishme për këtë vendim. Rrjedhimisht, Policia e Kosovës ka pasur mundësi të bollshme t'i jepte informacionet e kërkuara dhe çfarëdo informacionesh shtesë nuk do ta ndihmonin më tej Gjykatësin e Procedurës Paraprake në lidhje me këtë çështje.

98. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se asnjë masë shtesë e urdhëruar *proprio motu* nuk do të zvogëlonte mjaftueshëm rreziqet ekzistuese.

(iv) Përfundim

99. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se, edhe duke marrë parasysh Parashtrimet e Para dhe të Dytë të Policisë së Kosovës, kushtet e propozuara nga Mbrojtja mbeten të pamjaftueshme për të zvogëluar rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii)-(iii) të Ligjit në lidhje me z. Veseli dhe se, përveç kësaj, çfarëdo kushti shtesë që mund të vendoset nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk do të ndikojë në këtë përfundim. Për pasojë, siç u argumentua më lart, vetëm nëpërmjet sistemit të monitorimit në objektin e paraburgimit të DHS-së mund të kufizohen dhe monitorohen komunikimet e z. Veseli në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet që ai të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së ose të kryejë krime të tjera. Pasi ka vlerësuar dhe peshuar parashtrimet e palëve në tërësinë e tyre, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se faktorët e mësipërm vazhdojnë të mbeten vendimtarë në arritjen e këtij përfundimi dhe, për pasojë, nuk është e nevojshme të trajtohen më tej argumentet e tjera të palëve lidhur me këtë pikë – pa paragjykuar rezultatin që mund të kishte kryerja e vlerësimit të atyre argumenteve.

100. Për këtë arsye, pasi ka vlerësuar aspektin e Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin që Gjykata e Apelit e ktheu për rishqyrtim me Vendimin e Dytë të

Gjykatës së Apelit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmon Vendimin e Dytë mbi Paraburgimin. Po kështu, për të njëjtat arsye përfundimi i mësipërm vlen edhe për rishikimin e rregullt të paraburgimit të z. Veseli në bazë të nenit neni 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores.

F. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

1. Parashtrime

101. Në Kërkesën e saj Mbrojtja parashtron se si kohëzgjatja e periudhës së procedurës paraprake, ashtu edhe përgjegjësia e ZPS-së për vonesat në procedura, kanë krijuar një situatë ku vazhdimi i paraburgimit të z. Veseli në objektin e paraburgimit të DHS-së është i paligjshëm.¹⁷⁸ Sipas Mbrojtjes, që të dyja palët janë të mendimit se çështja nuk do t'i kalohet trupit gjykues në të ardhmen e parashikueshme, për shkak të faktorëve në vijim.¹⁷⁹ Së pari, Mbrojtja pretendon se nxjerrja e materialeve sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores mbetet e paplotë edhe pas ndryshimeve të shumta të afateve, dhe se ZPS-ja i ka shtrembëruar faktet në lidhje me përparimin e bërë në nxjerrjen e këtyre materialeve.¹⁸⁰ Së dyti, Mbrojtja pretendon se ZPS-ja ka bërë vlerësim të gabuar të ecurisë së nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3), sepse – pas ndryshimit disa herë të afateve – dorëzimi i njoftimit të ZPS-së sipas kësaj dispozite çoi në debate juridike të mëtejshme dhe, përveç kësaj, duket se ZPS-ja ende duhet të bëjë vlerësimin e materialeve të rregullës 102(3) që ka kërkuar Mbrojtja dhe të zbatojë redaktimet dhe masat e duhura mbrojtëse për dëshmitarët.¹⁸¹ Së treti, Mbrojtja pretendon se ZPS-ja nuk është në gjendje të japë vlerësimin se kur do të përfundojë nxjerrjen e informacionit shfaqësues dhe se është shumë shqetësuese që njoftimi sipas

¹⁷⁸ Kërkesa, para. 39, 65-67.

¹⁷⁹ Kërkesa, para. 38, 41-42, 44.

¹⁸⁰ Kërkesa, para. 38, 43, 45-49.

¹⁸¹ Kërkesa, para. 38, 43, 50-53.

rregullës 102(3) të Rregullores përmban materiale qartësisht shfajësuese.¹⁸² Së katërtri, sipas Mbrojtjes, edhe vlerësimet e ZPS-së për afatet e dorëzimit të dosjes së saj paraprake dhe të materialeve sipas rregullës 95(4) që lidhen me të, kanë qenë gjithashtu po aq problematike sa i takon premtimeve jorealiste për kryerjen me shpejtësi të procedurave.¹⁸³ Së fundi, ajo parashtron se vlerësimet e ndryshme të ZPS-së lidhur me datën e fillimit të gjykimit janë po aq të mangëta dhe, mbi këtë bazë, përsërit se çështja nuk do të jetë gati për gjykim para verës/vjeshtës së vitit 2022, më së shpejti.¹⁸⁴

102. ZPS-ja përgjigjet se vazhdimi i paraburgimit është proporcional.¹⁸⁵ Sipas saj, vlerësimet për afatet, qoftë të shkuara apo të tashme, nuk janë përcaktuese për proporcionalitetin e kohëzgjatjes së paraburgimit dhe nuk kanë qenë baza për konstatimet e mëparshme, qoftë të Gjykatës të Procedurës Paraprake apo të Gjykatës së Apelit.¹⁸⁶ Për më tepër, ZPS-ja pretendon se çështja ka përparuar më tej aktivisht drejt gjykimit dhe ZPS-ja ka përcaktuar 17 dhjetorin 2021 si datën për dorëzimin e dosjes paraprake, përfundimin e nxjerrjes së pjesës më të madhe të materialeve sipas rregullës 102(1)(b) nga ZPS-ja, dorëzimin e apeleve nga palët lidhur me mocionet paraprake dhe dorëzimin e një liste paraprake të dëshmitarëve më 22 tetor 2021.¹⁸⁷ ZPS-ja shton se, duke qenë se të gjitha proceset e procedurës paraprake po përparojnë, është i pabazë sugjerimi i Mbrojtjes se zgjatjet e përligjura të afateve për nxjerrjen e një sasive relativisht të vogël të materialeve të mbetura nga rregulla 102(1)(b) kanë vonuar fillimin e procesit gjyqësor ose zgjatur paraburgimin e të akuzuarit.¹⁸⁸

¹⁸² Kërkesa, para. 38, 43, 54-55.

¹⁸³ Kërkesa, para. 38, 43, 56-59.

¹⁸⁴ Kërkesa, para. 38, 43, 60-64.

¹⁸⁵ Përgjigjja, para. 36, 41.

¹⁸⁶ Përgjigjja, para. 38.

¹⁸⁷ Përgjigjja, para. 39.

¹⁸⁸ Përgjigjja, para. 40.

103. Mbrojtja kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk është përgjigjur në lidhje me vonesat, mosrespektimin e afateve dhe keqinterpretimet e saj.¹⁸⁹ Ajo shton se ZPS-ja gjithashtu nuk ka trajtuar parapëlqimin e qartë të shprehur në Kushtetutën e Kosovës dhe në Ligj për zbatimin e masave alternative më pak kufizuese se paraburgimi.¹⁹⁰ Po kështu, sipas Mbrojtjes, pretendimi i ZPS-së se procedurat po përparojnë shpejt është absurd, duke pasur parasysh se në fillim ZPS-ja pretendoi se çështja do të ishte gati për gjykim në verën e vitit 2021.¹⁹¹ Së fundi, Mbrojtja argumenton se duke pasur parasysh numrin e dëshmitarëve që ZPS-ja propozon t'i thërrasë për të dëshmuar, është e pamundur që gjykimi të fillojë intensivisht para fundit të vitit 2022 ose (më e mundshme) në fillim të vitit 2023, dhe vetë gjykimi me siguri do të zgjasë rreth tre vjet.¹⁹²

2. Diskutim

104. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton rëndësinë e parimit të proporcionalitetit në përcaktimin e arsyeshmërisë së paraburgimit – siç parashihet në rregullën 56(2) të Rregullores.¹⁹³ Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit është faktor që duhet marrë parasysh së bashku me shkallën e rreziqeve të përshkruara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, në mënyrë që, pasi janë peshuar të gjithë faktorët, të përcaktohet nëse vazhdimi i paraburgimit “pushon së qeni i arsyeshëm” dhe personi duhet të lirohet.¹⁹⁴ Megjithatë, çështja nëse periudha e kohës e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet vetëm në teori. Vlerësimi nëse vazhdimi i

¹⁸⁹ Kundërpërgjigjja, para. 33.

¹⁹⁰ Kundërpërgjigjja, para. 33.

¹⁹¹ Kundërpërgjigjja, para. 33.

¹⁹² Kundërpërgjigjja, para. 33.

¹⁹³ KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim*, 9 dhjetor 2020, publik, para. 72-73.

¹⁹⁴ *Në mënyrë të ngjashme* KSC-BC-2020-06, IA002/F00005/RED, Gjykata e Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit Kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 69.

paraburgimit të të akuzuarit është i arsyeshëm duhet të bëhet mbi bazën e fakteve të secilës çështje gjyqësore dhe sipas veçorive specifike të saj.¹⁹⁵

105. Z. Veseli u arrestua më 5 nëntor 2020, që do të thotë se deri në kohën e rishikimit aktual të paraburgimit të tij, ai ka qëndruar në paraburgim për pak më shumë se një vit. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të vlerësojë nëse kjo periudhë kohore është e arsyeshme në rrethanat konkrete që lidhen me z. Veseli.

106. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se akuzat e ngritura kundër z. Veseli janë tejet të rënda.¹⁹⁶ Konkretisht, kundër z. Veseli janë paraqitur dhjetë akuza për krime të rënda ndërkombëtare: përndjekje për arsye politike dhe/ose etnike, burgosje/arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar, akte të tjera çnjerëzore, trajtim mizor, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë e personave.¹⁹⁷ Gjithashtu pretendohet se z. Veseli ka luajtur rol të konsiderueshëm në këto krime.¹⁹⁸ Për këto arsye, në rast se shpallet fajtor, ai mund të dënohet me burgim të gjatë, përfshirë burgim të përjetshëm.

107. Për rrjedhojë procesi kundër z. Veseli është i ndërlikuar.¹⁹⁹ Krimet e pretenduara u kryen në një periudhë të gjatë (më së paku që nga marsi i vitit 1998 deri në shtator të vitit 1999), në një zonë të madhe gjeografike (vendndodhje të shumta në Kosovë dhe disa rrethe në veri të Shqipërisë), dhe patën dhjetëra

¹⁹⁵ ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], para. 90.

¹⁹⁶ *Shih edhe* ECtHR, *Shabani v. Switzerland*, no. 29044/06, [Judgment](#), 5 nëntor 2009 ("*Shabani v. Switzerland*"), para. 65, 66, 69; ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21, [Decision on Motion for Provisional Release Filed by the Accused Zejnil Delalic](#), 25 shtator 1996, para. 20, 26; *Prosecutor v. Ademi*, IT-01-46-PT, [Order on Motion for Provisional Release](#), 20 February 2002 ("*Ademi Decision*"), para. 25; ICTR, *Prosecutor v. Ndayambaje*, ICTR-98-42-T, [Decision on the Defence Motion for the Provisional Release of the Accused](#), 21 tetor 2002 ("*Ndayambaje Decision*"), para. 23; *Prosecutor v. Ngirumpatse et al.*, ICTR-98-44-T, [Decision on the Motion by Ngirumpatse's Defence to Find the Accused's Detention Unlawful or, in the Alternative, to Order his Provisional Release](#), 18 August 2003 ("*Ngirumpatse Decision*"), para. 25.

¹⁹⁷ Aktakuza e Konfirmuar, para. 173.

¹⁹⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 5, 32, 39, 40-42, 47, 49, 53-55, 172.

¹⁹⁹ *Shih edhe* ECtHR, *Shabani v. Switzerland*, para. 65, 69; ICTY, [Ademi Decision](#), para. 26; ICTR, [Ndayambaje Decision](#), para. 23; *Ngirumpatse Decision*, para. 25.

viktima.²⁰⁰ Gjithashtu, ZPS-ja deklaroi paraprakisht se synon të mbështetet në një numër të madh dëshmitarësh²⁰¹ [REDAKTUAR].

108. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon me shumë rëndësi, sikurse është përcaktuar, se vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet që, në qoftë se lirohet, z. Veseli të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së ose të kryejë krime të tjera dhe këto rreziqe nuk mund të zvogëlohen në mënyrë të mjaftueshme nëpërmjet masave më pak kufizuese.

109. Përveç kësaj, sa i takon kryerjes së procedurave nga palët,²⁰² Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se pas Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin janë përfunduar hapa të konsiderueshëm proceduralë për kalimin e çështjes për gjykim në të ardhmen. Konkretisht, janë miratuar disa vendime mbi kërkesat për masa mbrojtëse,²⁰³ janë dhënë vendime mbi mocionet paraprake të Mbrojtjes,²⁰⁴ është caktuar 17 dhjetori 2021 për dorëzimin e dosjes paraprake të ZPS-së dhe 28 janari 2022 për dorëzimin e tabelës sipas rregullës 109(c),²⁰⁵ ZPS-ja do të përfundojë nxjerrjen e materialeve të rregullës 102(1)(b) të Rregullores më 31 janar 2022,²⁰⁶ dhe ZPS-ja ka dorëzuar një listë paraprake dëshmitarësh, që do të ndihmojë edhe Mbrojtjen në hetimet e saj.²⁰⁷ Në lidhje me vonesat e ZPS-së dhe afatet e parashikuara prej saj, që thekson Mbrojtja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se afatet përkatëse janë zgjatur kur janë dhënë arsye bindëse. Sidoqoftë,

²⁰⁰ Aktakuza e Konfirmuar, para. 16, 32, 57-171, listat A-C.

²⁰¹ KSC-BC-2020-06, F00542, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listës Paraprake të Dëshmitarëve prej Prokurorisë*, 22 tetor 2021, publik ("Lista Paraprake e Dëshmitarëve të ZPS-së"), me Shtojcën 1 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* dhe Shtojcën 2 të redaktuar konfidenciale.

²⁰² *Shih edhe* ECtHR, *Shabani v. Switzerland*, para. 67-68.

²⁰³ *Shih* poshtëshënimin 88 më lart.

²⁰⁴ KSC-BC-2020-06, F00412, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara*, 22 korrik 2021, publik; F00413/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 22 korrik 2021, publik; F00450, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve*, 31 gusht 2021, publik.

²⁰⁵ Transkripti i 29 Tetorit 2021, f. 752, rreshti 20 – f. 753, rreshti 5.

²⁰⁶ Transkripti i 29 Tetorit 2021, f. 752, rreshti 20 – f. 753, rreshti 5, f. 753, rreshti 6 – f. 754, rreshti 4.

²⁰⁷ Lista Paraprake e Dëshmitarëve të ZPS-së.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të paraburgimit të z. Veseli, duhet të vlerësohet kohëzgjatja reale e paraburgimit dhe jo përllogaritjet e ZPS-së, që më vonë rezultuan të pasakta. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur mbahet parasysh se, me gjithë vonesat në lidhje me afate të caktuara, vazhdon të bëhet përparim drejt përfundimit të fazës së procedurës paraprake në një të ardhme të parashikueshme.

110. Në përfundim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në rrethanat konkrete të çështjes në fjalë, periudha që z. Veseli ka kaluar në paraburgim para gjykimit, që është pak më shumë se një vit, nuk është e paarsyeshme duke patur parasysh: (i) peshën e skajshme të krimeve për të cilat akuzohet z. Veseli dhe rolin e rëndësishëm të pretenduar të tij në kryerjen e këtyre krimeve; (ii) mundësinë e dënimit të rëndë në rast se shpallet fajtor; (iii) kompleksitetin e çështjes kundër z. Veseli; (iv) ekzistencën në vijimësi të rreziqeve sipas nenit 41(6)(b)(ii)-(iii) të Ligjit dhe pamundësinë për t'i zvogëluar mjaftueshëm rreziqet nëpërmjet masave më pak të kufizuara; dhe (v) përparimin e bërë në këto procedura, me gjithë vonesat lidhur me afate të caktuara.

111. Gjithashtu, sa i takon pretendimit të Mbrojtjes se ZPS-ja ka shkaktuar vonesë të papërligjur brenda kuptimit të fjalisë së dytë të rregullës 56(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ky argument rrëzohet pasi, sikurse është përmendur, për vonesat lidhur me afate të caktuara janë dhënë arsye bindëse dhe vazhdon të bëhet përparim drejt përfundimit të fazës së procedurës paraprake në një të ardhme të parashikueshme.

112. Së fundi, lidhur me kërkesën e Mbrojtjes për rishikimin e kohëzgjatjes së gjithsejtë të pritshme të paraburgimit të z. Veseli, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, megjithëse deri tani nuk është caktuar ende data për fillimin e gjykimit, paraburgimi i z. Veseli do të rishikohet çdo dy muaj, ose sapo të ketë ndryshim në rrethana sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të

Rregullores.²⁰⁸ Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në fazën aktuale, çdo diskutim në lidhje me kohëzgjatjen në tërësi të paraburgimit të z. Veseli vazhdon të jetë i parakohshëm dhe hamendësues.²⁰⁹

V. VENDIM

113. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **KONFIRMON** Vendimin e Dytë mbi Paraburgimin;
- b) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të Z. Veseli;
- c) **HEDH POSHTË** kërkesën e Mbrojtjes për të hequr nga dokumentacioni paragrafët 2-3, 5-9 dhe 23-25 të Parashtrimeve të ZPS-së;
- d) **URDHËRON** Mbrojtjen, ZPS-në dhe Zyrën Administrative të dorëzojnë versionet e redaktuara, përkatësisht, të Kërkesës, Kundërpërgjigjes, Parashtrimeve të ZPS-së, Parashtrimeve të Mbrojtjes dhe Parashtrimeve të Zyrës Administrative jo më vonë se **të hënën, 29 nëntor 2021**, ose të informojnë, deri në të njëjtën datë, se ndonjë prej këtyre dokumenteve duhet të mbajë të njëjtin klasifikim;
- e) **URDHËRON** Mbrojtjen që, nëse dëshiron, të dorëzojë parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Veseli jo më vonë se **të premtën, 17 dhjetor 2021**, ndërsa përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas kalendarit të përcaktuar në rregullën 76 të Rregullores; dhe
- f) **URDHËRON** ZPS-në që, në rast se Mbrojtja vendos të mos dorëzojë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të dorëzojë parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Veseli jo më vonë se **të**

²⁰⁸ Në mënyrë të ngjashme ECtHR, *Ereren v. Germany*, no. 67522/09, [Judgment](#), 6 nëntor 2014, para. 64.

²⁰⁹ Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 59; Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e *Krasniqit*, para. 43; Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e *Thaçit*, para. 51.

**premten, 31 dhjetor 2021 dhe, Mbrojtjen që, nëse dëshiron, të dorëzojë
parashtrimet e saj jo më vonë se të hënën, 10 janar 2022.**

_____/nënshkrimi/_____

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E martë, 23 nëntor 2021

Hagë, Holandë